



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:183761  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05871367

CAP.nr.782/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Nora Bllaca Dula, në çështjen përmbartimore të kreditorëve E.N dhe A.M, që të dy nga P....., të cilët sipas autorizim i përfaqëson R.P, avokat nga Peja, kundër debitorit të përmbartimit Qeveria e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës, të cilën e përfaqëson në cilësinë e përfaqësueses Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, me seli në Prishtinë, lidhur me propozimin për përmbartim të dokumentit përmbartues – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, me numër C.nr.338/19, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.452/2023, të datës 29.11.2023, me datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit të përmbartimit Qeveria e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.452/2023, të datës 29.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.452/2023, të datës 29.11.2023, ka vendosur si në vijim: “*I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit P.nr.230/2023 të dt. 20.07.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat – F.Sh, sipas propozimit për përmbartim të datës 20.07.2023, për lejimin e përmbartimit të dokumentit përmbartues Aktgjykimit C.nr.338/2019 i datës 04.09.2019.*

*II. MBETET NË FUQI Urdhri P.nr.230/2023 i datës 20.07.2023, i lëshuar nga Përmbauesit Privat Fatos Shatri, me seli në Istog”.*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbaimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim drejtuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa e debitorit si e bazuar, të shfuqizohet aktvendimi dhe të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

*-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka parashtruar propozim për përmbaimit me datën 20.07.2023, ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbaimit Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.338/2019 i datës 04.09.2019 i plotfuqishëm me datë 08.05.2023, i ekzekutueshëm i datës 17.07.2023, duke e detyruar debitorin që kreditorëve t’ua kompensojë në shumën prej 93.440 € në emër të kompensimit të tokës së poseduar me kamatë ligjore siç e paguajnë bankat vendore në afat mbi një vit pa destinim të caktuar e duke filluar nga data 04.09.2019 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbauesi privat me urdhrin përmbaimit P.nr.230/23 të dt.20.07.2023, e ka lejuar propozimin për përmbaimit në këtë çështje përmbaimore.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbaimit, debitori në afat të rregullt ligjor ka ushtruar prapësim, duke e kontestuar në tërësi si të pabazuar urdhrin për lejimin e përmbaimit të propozuar nga kreditori, me arsyetimin se përmbaimit i vendimit të tillë do ti sillte dëm të madh Ministrisë së Infrastrukturës. Andaj duke pas parasysh thëniet e cekura më lartë, përfaqësuesja e debitorit, i ka propozuar që kjo Gjykatë të merr aktvendim të miratohet prapësim i debitorit dhe të shfuqizohet Urdhri Përmbaimit P.nr.230/2023, i datës 20.07.2023

Kreditorët, me datë 04.08.2023, kanë ushtruar përgjigje në prapësim, me të cilin e kanë konsideruar prapësimin si të pa bazuar, për faktin se propozimi për përmbaimit është i rregullt, i çartë, përmban të gjitha elementet për përmbaimit, kreditorin, debitorin, objektin e kontestit, shumën dhe se arsyetimi se përmbaimit i një vendimi të tillë, do ti sjell dëm të madh, nuk paraqet shkasë për shfuqizimin e urdhrin përmbaimit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.452/2023, të datës 29.11.2023, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se pas vlerësimit të prapësimit të debitorit gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për arsye se pretendimet nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarrimin e lejuar, duke shtuar se dokumenti mbi të cilin është mbështetur urdhri mbi lejimin e përmbarrimit ka titull ekzekutiv dhe se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parapara nga neni 71 par 1 nën par 1.1 – 1.12 të LPP –së, po ashtu debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova siç parashihet në nenin 69 par 4 të LPP –së. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se urdhri përmbarrimor P.nr.230/23 i datës 20.07.2023, me të cilin është lejuar përmbarrimin, është lëshuar në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.338/2019 i datës 04.09.2019, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 08.05.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 17.07.2023 me këtë aktgjykim tani debitori është detyruar që kreditorëve t'iu kompensojë dëmin në emër të tokës së poseduar si në vendimin e lartcekur.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se aktgjykimi në fjalë në bazë të të cilit edhe është lejuar përmbarrimi është dokument përmbarrues, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga nenet: 21, 22 paragrafi 1 pika 1, 23 paragrafi 1, 24 paragrafi 1 si dhe 27 paragrafi 1 të LPP-së, për të qenë i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit të parë lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbarrimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përmbarrues në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi është Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.338/2019 i datës 04.09.2019, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 08.05.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 17.07.2023 e cila në rastin konkret është dokument përmbarrues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: “*dokument përmbarrimor është vendimi përmbarrues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbarruese*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarrimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: “*dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Pretendimet e debitorit për shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përbarimore gjykata me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke ju përmbajtur parimit të rigozitetit formal-juridik që nënkupton se gjykata do të vlerësoj shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera, pasi që këto pretendime kanë mundur të paraqiten në kohën kur është marrë dokumenti përbarues.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përbarimit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarja individuale në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së (i cili është në fuqi aktualisht, me numër 04 L-139), me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.782/2024, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja  
Nora Billaca Dula, d.v